

VENDIM
Nr. 84, datë 24.4.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13 pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1497/2 prot., datë 23.4.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 2’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1497 prot., datë 10.4.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1, gerrat (“a”, “b” dhe “c”) të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar formularin e aplikimit të plotësuar sipas formatit të shtojcës 1, të nënshkruar dhe të vulosur në të gjithë elementët e saj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se aplikuesi ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duke plotësuar të dhënat për subjektin “SPV Blue 2” sh.p.k., NUIS-in, adresën, numrin e telefonit, adresën e e-mailit dhe emrin e administratorit. Aplikuesi ka deklaruar se nuk i është hequr apo refuzuar më parë ndonjë licencë për operimin në sektorin e energjisë elektrike brenda apo jashtë vendit, se është njohur me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi dhe angazhohet për respektimin e tij, si dhe të rregullave dhe rregulloreve të miratuara nga ERE për këtë veprimtari. Gjithashtu, ka deklaruar se dokumentet dhe të dhënat e paraqitura janë të vërteta dhe është i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimit të të dhënave të pavërteta ose të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara. Aplikuesi ka shprehur gjithashtu gatishmërinë për të marrë pjesë në seanca dëgjimore pranë ERE-s nëse kërkohet dhe ka kryer pagesën e tarifës së aplikimit më datë 15.4.2025, pranë Bankës “Tirana Bank” sh.a., në përputhje me përcaktimet e aneksit A të rregullores.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave (“a”, “c” dhe “d”). Në zbatim të germës “a”, është paraqitur ekstrakti historik i regjistrit tregtar, i vulosur elektronikisht nga QKB-ja, më datë 26.3.2025, nga i cili rezulton se shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. është regjistruar më datë 17.3.2021 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Në mbështetje të germës “c”, aplikuesi ka dorëzuar strukturën organizative të shoqërisë, e cila përfshin Asamblenë e Aksionerëve, Administratorin, Departamentin Teknik (me nënkontraktorin për operim dhe mirëmbajtje, menaxherin e operimit, përgjegjësin për leje dhe autorizime dhe zyrën e Shëndetit dhe Sigurisë Mjedisore), Departamentin e Administratës (me sektorin e financës, kontabilitetit, juridikut dhe prokurimit/logistikës), si dhe Departamentin e Shitjes (për

shitjen, tregtimin, skedulimin, matjet dhe balancimin). Nga shqyrtimi i kësaj strukture rezulton se shoqëria ka kapacitetet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike. Në lidhje me germën “d”, rezulton se nuk aplikohet, pasi aplikuesi nuk ka caktuar një përfaqësues ligjor dhe për rrjedhojë nuk ka depozituar akt përfaqësimi në ERE.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3, germa “a” të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin që vërteton mungesën e detyrimeve të pashlyera ndaj organeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Në këtë kuadër, janë depozituar në ERE vërtetimi i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve DTM, më datë 26.3.2025, dhe vërtetimi i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë, më datë 26.3.2025, nga të cilët rezulton se shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. nuk ka asnjë detyrim tatimor apo detyrime të papaguara lidhur me kontributet për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi deri në datën e lëshimit të këtyre dokumenteve.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2.5 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar informacionin mbi sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë gjatë pesë viteve të vlefshmërisë së licencës.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”:

Shoqëria ka paraqitur vërtetimin e gjendjes gjyqësore të administratorit, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me nr. kërkesë 20, datë 11.3.2025, nga i cili rezulton se administratori është i padënuar. Gjithashtu, është dorëzuar vërtetimi i gjendjes gjyqësore për subjektin “SPV Blue 2” sh.p.k., me nr. 19 prot., datë 6.3.2025, ku rezulton se edhe shoqëria është e padënuar. Megjithatë, duke qenë se sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3 të Rregullores, vërtetimet duhet të jenë të lëshuara jo më herët se një muaj nga data e paraqitjes së aplikimit, vlerësohet se duhet t’i kërkohej aplikuesit dorëzimi i një vërtetimi të përditësuar për shoqërinë.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “b”:

Aplikuesi ka dorëzuar pasqyrat financiare të audituara për vitet kontabël 2022, 2023 dhe 2024, nga të cilat rezulton se shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k., e regjistruar më datë 17.3.2021, ka realizuar shpenzime për paga, sigurime shoqërore dhe investime, por nuk ka gjeneruar fitime në këto tre vite. Shoqëria ka depozituar gjithashtu parashikimin për sasinë e energjisë elektrike që planifikon të tregtojë gjatë pesë viteve të ardhshme, ku për vitin e parë është parashikuar një sasi prej 99,585 MWh në vit, ose rreth 8,299 MWh për një muaj. Në planin e biznesit, përllogaritjet fillestare janë kryer duke marrë si referencë çmimin në bursën HUPEX, por në përputhje me kërkesat e rregullores dhe vendimin unifikues të Bordit të ERE-s nr. 16, datë 16.1.2025, është marrë për bazë çmimi mujor i Ditës në Avancë i bursës ALPEX për muajin mars 2025, në vlerën 135,53 euro/MWh. Duke qenë se nga pasqyrat financiare të dorëzuara rezulton se shoqëria nuk disponon të ardhura të mjaftueshme për të garantuar këtë vlerë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion tjetër për mbështetje financiare, vlerësohet që të kërkohej nga aplikuesi depozitimi i dokumentacionit për të mbuluar të paktën 1 muaj të ushtrimit të aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike.

- germa “c”:

Aplikuesi ka dorëzuar planin e biznesit për periudhën 2025–2030 mbi aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike në Shqipëri. Dokumenti përfshin një vështrim të përgjithshëm mbi sektorin dhe tregun e energjisë elektrike për periudhën 2021–2024, si dhe parashikime për pesë vitet e ardhshme në lidhje me sasinë e energjisë që do të tregtohet, kostot, të ardhurat dhe shitjet, në përputhje me kërkesat e kësaj pike të rregullores. Sa i takon modalitetit të financimit të veprimtarisë së tregtimit, në planin e biznesit (në pikën 5.3 “Projeksioni i të ardhurave dhe shpenzimeve mujore”) janë parashikuar

të ardhura dhe shpenzime që lidhen me aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike dhe jo konkretisht me veprimtarinë e tregtimit. Duke marrë në konsideratë se, aktualisht shoqëria nuk ka filluar të gjenerojë të ardhura nga veprimtaria e prodhimit, rezulton se nuk është përcaktuar ende mënyra e mbulimit të mbështetjes financiare për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike për të paktën një muaj. Për këtë arsye, vlerësohet e nevojshme që shoqëria ta saktësojë këtë element në vijim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti